

SKEDË TEKNIKE

ROFIX CalceClima® Finish Decor

Masë shpatulluese pastoze prej gëlqereje




Fushat e përdorimit

Masë shpatulluese, e gatshme, shtresë hollë e prodhuar në fabrikë. Suva universale, e bardhë, e lëmuar me bazë gëlqere për muret e brendshme dhe tavanin mbi bazamentet prej betoni, suvaje dhe karton gipsi. Për lyerjen e pjesës së brendshme të tavanit, pjesë parafabrikat, pllakave për ndërtimin e mureve, sikurse dhe për njëtrajtëzimin suvave të poshtme me bazë gëlqere-çimeto.

Karakteristikat

- i lëmueshëm
- I përdorshëm në mënyrë universale

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	50101	50102
EAN	9003304508921	9003304508938
Paketimi		
Sasi për njësi	25 kg/Nj.	5 kg/Nj.
Njësi për paletë	24 Nj./Pal	64 Nj./Pal
Ngjyra	e bardhë	
Konsumi	rreth. 1,6 kg/m ² /mm	
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit. Kur zhvillohet punimi për herë të parë dhe në raste të aplikimit në sipërfaqe të mëdha këshillohet realizimi paraprakë në një sipërfaqe prove.	
Difuzioni i avullit të ujit	≤ 20	
Hapja e difuzionit të avullit	Përshkueshmëri normale	
Trashësia minimale e suvasë	1 mm	
Vlera e pH	11,5	
Trashësia e shtresës	1-2 mm	
Pesha specifike	1,7 kg/L	

RÖFIX CalceClima® Finish Decor

Masë shpatulluese pastoze prej gëlqereje

Numri i artikullit	50101	50102
Temperatura e nënshtresës	5 °C	
Këshilla për paketimin	Në kova plastike të riciklueshme	

Baza e materialit

- Lidhës dispersiv (< 1,5 %)
- Gëlqere e pashuar

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamenti nuk duhet të bjerë nën +5 °C.

Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blozë, kripra etj. . Pastrojini nga lëndët ndarëse (dyll, vaj armature, etj). Suvatë mbushëse me bazë gipsi duhet të jenë të thata dhe të forta plotësisht. Suvate mbushëse me bazë çimento/gëlqere mund të suvatohen pas ngurtësimit.

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Lemoni perkatesisht perforoni fugat ndermjet elementeve te ndertimit dhe ne fund lerini te thahen mire.

Përgatitja

Produkt i gatëshëm për përdorim Përpara përdorimit përziejeni shkurt. Materiali është menduar me veti thikotrope (sa më gjatë dhe më intensivisht të përziehet, aq më e hollë përmbajtja - pasi qëndron për një kohë të gjatë në kovë, fillon e trashet vetvetiu).

Këshilla për përpunimin

Koha e tharjes para aplikimit të shtresës së fundit, rreth 24 orë (sipas temperaturës dhe kushtet atmosferike). Çdo shkallëzim i shkaktuar gjatë përpunimit mund të hiqet me letër zmerile (180/220) pas një periudhe prej 3-5 ditësh. Duhet bere kujdes qe para shtreses se dyte, bazameti te jete mat njetrajtesisht (pa vende te lageshta apo njolla). Pastrojini me kujdes veglat e punës pas përdorimit. Nw dorwn e parw hollojeni me max. 5% ujw Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

Përpunimi

Shtrimi kryhet nëpërmjet një mistrie inoksi të lëmuar. Pjesët kufizuese të ndërtesës (si dyer, dritare korniza dritaresh etj) përgjithësisht duhet të mbulohen para punimeve për të mënjeluar ndotjen ose korrozionin.

Magazinimi

Magazinojini në vende të freskëta, të mbrojtur nga ngrica dhe të mbyllura mirë. Magazinimi min. 24 muaj.

Certifikatë



ROFIX CalceClima® Finish Decor

Masë shpatulluese pastoze prej gëlqereje

Etiketë



Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme. Vlerat teknike janë bazuar tek produktet bazë. Gjatë pigmentimit ose ngjyrosjes, janë të mundshme edhe devijime nga të dhënat teknike. Në dhënien e vlerave bëhet fjalë për vlera mesatare. Meqënëse produktet tona përbëhen nga materiale natyrore, mund të ndodhë që në një ngarkesë të kemi edhe devijime minimale të vlerave. Për veshjen e sipërfaqeve, të cilat këtu nuk janë përshkruar, do të ishte i nevojshëm një marrje mendimi nga ana jonë. Në rast porositje plotësuese ose në lidhje me katalogun e ngjyrave, pigmentet mund të ndryshojnë minimalisht, prandaj dhe në kantiere duhet të bëni si fillim një mostër për krahasim. Të dhënat në lidhje me kohën e pritjes-veprimit janë përcaktuar në kushtet e laboratorit (+20 °C/65 % Lageshtirë/e mbetur) dhe sipas kushteve të kantierit mund të ndryshojnë. Shërbimi ynë i konsulencës teknike është në dispozicionin tuaj në rast pyetjesh lidhur me përdorimin, përpunimin si dhe demonstrimin e produkteve tona. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.